




KOMUNA SHTIME



AMJ

Nr. prot: 02/395
21/04/2026

Essay-Contest-Shtime/2026

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

lidhur ndërmjet

KOMUNËS SË SHTIMES

dhe

AMJ

Për garën e II-të akademike ndërkomunale për ese, që do të mbahet gjatë muajit prill 2026, në 6 shkolla nga 6 komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës.

Shtime, 21.04.2026

QËLLIMI

Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Shtimes dhe AMJ është zhvillimi i garës së II-të akademike ndërkomunale për ese, me nxënësit e përzgjedhur të klasës së VIII-të të shkollave fillore të Komunës së Shtimes.

ORGANIZIMI I GARËS

Kjo garë akademike ndërkomunale për ese do të mbahet gjatë muajit prill 2026 në gjashtë shkolla të ndryshme fillore dhe të mesme të Republikës së Kosovës.

LLOJI I SHPËRBLIMIT

Për nxënësit fitues të garës së II-të akademike ndërkomunale në ese do të ketë gjithsej 3 shpërblime:

Vendi i parë = 4 kuponë shpërblyes në vlerë 250€;

Vendi i dytë = 3 kuponë shpërblyes në vlerë 150€; dhe

Vendi i tretë = 2 kuponë shpërblyes në vlerë 100€.

FORMA E DHURIMIT TË SHPËRBLIMIT

Në pajtim me të dyja palët e lidhjes së këtij memorandumi mirëkuptimi është caktuar që forma e dhurimit të shpërblimit të bëhet në këtë mënyrë:

- Vendi i parë: 1 kupon në vlerë 100€ për blerje të materialit shkollor, 1 kupon 50€ për gjësende ushqimore, 1 kupon në vlerë 50€ për restaurant dhe 50€ cash¹;
- Vendi i dytë: 1 kupon në vlerë 50€ për blerje të materialit shkollor, 1 kupon 50€ për gjësende ushqimore dhe 50€ cash;
- Vendi i tretë: 1 kupon në vlerë 50€ për blerje të materialit shkollor dhe 50€ cash.

PËRGJEGJËSITË E KOMUNËS SË SHTIMES:

1. Komuna e Shtimes përzgjedh shkollën dhe përmes kësaj shkolle përzgjedh nxënësit të ndryshëm të klasës së VIII^{te} që do të marrin pjesë në garën e II-të akademike ndërkomunale në ese;

2. Të jenë të përpiktë në respektim të orarit dhe datës së caktuar të zhvillimit të garës së eseve;

3. Angazhon së paku një përfaqësues komunal ose të shkollës për të ndihmuar në mbarrëvajtjen e garës 45-minutëshe në shkrimin e eseve;

4. Përzgjedh klasën ku do të zhvillohet gara;

5. Pasi të përfundojë gara, dorëzon fletët e eseve të shkruara te përfaqësuesi i AMJ për vlerësim të mëtutjeshëm nga juria e jashtme 4-anëtarëshe.

PËRGJEGJËSITË E AMJ QË:

1. Përmes përfaqësuesit të saj, obligohet t'i sigurojë së paku dy fletë A4, me vija dhe me numër të veçantë reference, për të gjithë nxënësit që parashihen të marrin pjesë në garën e eseve;

2. Përmes përfaqësuesit të saj, obligohet që pas përfundimit të garës, të mbledhë të gjitha fletët dhe t'ia dorëzojë komisionit të jurisë katër-anëtarëshe për vlerësim të mëtejshëm;

3. Përmes një programi simbolik, do të ndajë shpërblimet për vendin e parë, dytë dhe të tretë në mes të muajit maj 2026, në praninë e përfaqësuesve komunalë, përfaqësuesve të shkollës ku do të mbahet gara dhe përfaqësuesve vendorë e ndërkombëtarë të AMJ.

4. Pas përfundimit të aktivitetit dhe shpërndarjes së shpërblimeve, esetë e nxënësve bëhen pronë e organizatorit të garës akademike ndërkomunale në shkrimin e eseve.

¹ Vlera 50€ (pesëdhjetë euro) dhurohet në praninë e prindit ose të kujdestarit të nxënësit/nxënëses.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Ky memorandum është nënshkruar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe.


HYRJA NË FUQI

Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët, dhe zbatimi i saj fillon më datë: _____.

Vendi: Shtime,

Data: _____

Komuna e Shtimes



(vula dhe nënshkrimi)

AMJ

(vula dhe nënshkrimi)